INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS

KULETAT
E SUBJEKTEVE POLITIKE PARLAMENTARE 3.0

Dhjetor, 2024

TRANSPARENCY INTERNATIONAL
the global coalition against corruption

Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2024. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239
10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0) 38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Ueb: www.kdi-kosova.org

Autor: Eugen Cakolli

Sqarim: Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Çeke në kuadër të Programit për Promovimin e Tranzicionit të implementuar në bashkëpunim me Transparency International Czech Republic (www.transparency.cz). Opinionet, gjetjet dhe rekomandimet në këtë raport janë përgjegjësi ekskluzive e KDI-së, ndaj nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. HYRJE

2. STATUSI I ZYRËS PËR KONTROLLIN FINANCIAR
   - 2.1 Burimet dhe stafi
   - 2.2 Performanca dhe efikasitet

3. PROCESI I AUDITIMIT TË RAPORTEVE TË SUBJEKTEVE POLITIKE
   - 3.1 Opinionet dhe gjetjet nga auditimi
   - 3.2 Problematikat e vazhdueshme në financimin e partive politike
   - 3.3. Përmbledhje e detajuar e gjetjeve specifike për partitë politike
   - 3.3.1 Problemet e partive lidhur me transparencën financiare
   - 3.3.2 Mosrespektimi i dispozitave ligjore
   - 3.3.3 Rreziqet dhe parregullsitë në menaxhimin financiar
   - 3.4 Trende krahasimore mes viteve 2023 dhe 2022
   - 3.5 Implikimet për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025

4. PËRMBLEDHJE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR VITIN 2023
   - 4.1 Trendet kryesore në burimet e financimit
   - 4.2 Krahasimi i kategorive të shpenzimeve kryesore

5. REKOMANDIMET

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport analizon praktikat financiare të partive politike në Kosovë, sipas raporteve vjetore financiare të vitit 2023, duke u fokusuar në përputhjen me dispozitat ligjore dhe respektimin e standardeve për transparencën dhe llogaridhënien financiare. Bazuar në auditimet e zhvilluara nga auditorë të kontraktuar nga nga Zyra për Kontroll Financiar, punimi evidenton disa përparime në mekanizmat mbikëqyrës, ndërsa thekson mangësitë e vazhdueshme në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies financiare.

Auditimi ka përfshirja pasqyrat vjetore financiare të 54 partive politike të regjistruara, duke përfshirë 15 subjekte të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës që përfitojnë fonde publike nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike. Rezultatet e auditimit dallojnë ndjeshëm në mes të partive. Në mesin e partive parlamentare, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) mori opinion të pakualifikuar, derisa të tjerat, përfshirë Lëvizjen Vetëvendosje (LVV), Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), morën opinione të kualifikuara për shkak të dokumentacionit të paplotë mbi shpenzimet, si dhe mosrespektimit të rregulloreve të prokurimit. Opinion të kualifikuar mori edhe Lista Serbe (SL), ndonëse tek ajo u evidentuan probleme serioze që ndërlidhen me mungesën e transparencës dhe llogaridhënies financiare, por edhe dyshimeve për veprime të tjera jo-ligjore.

Financimi përmes fondeve publike përbën burimin kryesor të të ardhurave për shumicën e subjekteve politike. Financimi politik plotësohet edhe nga kontributet private, si donacionet dhe kuotat e anëtarësisë. Sidoqoftë, raportet e auditimit zbuluan mospërputhje në raportimin e të ardhurave, veçanërisht për donacionet në natyrë dhe pranimin e donacioneve në para të gatshme, të cilat janë të ndaluara me ligj. Shpenzimet e partive ishin të përqendruara kryesisht në tri fusha kryesore: kostot për personelin, shpenzimet operative dhe aktivitetet reklamuese ose promovuese. Partitë e vogla hasën vështirësi për të mbuluar operacionet bazike për shkak të burimeve të kufizuara.

Raporti gjithashtu vë në pah sfida sistemike që cenojnë integritetin e financimit politik në Kosovë. Më e rëndësishmja nga këto është mungesa e qasjes së publikut në transaksionet, respektivisht qarkullimet e detajuara të llogarive bankare të partive politike, që kufizon transparencën dhe pengon mbikëqyrjen nga shoqëria civile. Për më tepër, pabarazia në aftësitë menaxheriale financiare mes partive të mëdha dhe të vogla mbetet problematike.

Ky raport thekson gjithashtu nevojën për të adresuar këto sfida, veçanërisht në prag të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, duke ofruar rekomandime konkrete për përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe menaxhimit financiar të partive politike.

HYRJE

Transparenca dhe llogaridhënia financiare e partive politike janë dy prej shtyllave kryesore të qeverisjes demokratike dhe besimit të publikut në procese zgjedhore. Në Kosovë, kuadri ligjor që rregullon financimin e partive politike, veçanërisht Ligji për Financimin e Subjekteve Politike dhe amendamentimet e tij, kërkon raportime financiare dhe auditime të rregullta për të siguruar përputhjen me rregulloret e vendosura.

Ky raport analizon raportet financiare të partive politike për vitin 2023, si dhe gjetjet nga auditimet e kryera nga auditorë të përcaktuar nga Zyra për Kontroll Financiar, e cila funksionon nën Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Objektivi kryesor i këtij raporti është të ofrojë një vlerësim gjithëpërfshirës të praktikave financiare të partive politike dhe efektivitetit të mekanizmave mbikëqyrës financiar. Raporti evidenton trendet e të hyrave dhe shpenzimeve të subjekteve politike, si dhe vlerëson zbatimin e kërkesave ligjore.

Për më tepër, raporti vlerëson funksionimin dhe kapacitetet e Zyrës për Kontroll Financiar, e cila është thelbësore për sigurimin e integritetit në financimin politik në Kosovë. Pavarësisht përparimeve të rëndësishme gjatë viteve të fundit, Zyra vazhdon të përballet me sfida sistemike.

Kjo analizë mbështetet në aspekt krahasimor edhe në gjetjet e raportit të KDI-së të vitit 2022 dhe përfshin gjetje të reja nga cikli i auditimit për vitin e fundit. Raportet financiare vjetore të subjekteve politike për vitin 2023 janë të parat që janë audituar plotësisht në përputhje me legjislacionin e ndryshuar (në vitin 2022) për financimin politik. Duke adresuar çështjet e vazhdueshme problematike dhe duke identifikuar trendet e reja, ky raport synon të kontribuojë në forcimin e mbikëqyrjes financiare.

STATUSI I ZYRËS PËR KONTROLLIN FINANCIAR

Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (tutje: Zyra për Kontrollin Financiar) luan një rol kyç në sigurimin e llogaridhënies dhe transparencës financiare të subjekteve politike në Kosovë. Pavarësisht përmirësimeve të dukshme në kapacitetet dhe performancën e saj gjatë viteve të fundit, Zyra vazhdon të përballet me sfida sistemike që cenojnë në disa raste efektivitetin e saj.

Në mesin e vitit 2024, KQZ miratoi legjislacionin sekondar që rregullon kontrollin financiar, disa muaj pas fillimit të procedurave të auditimit për partitë politike. Zyra e kishte përgatitur këtë legjislacion paraprakisht, por miratimi i të njëjtit ishte vonuar nga vendimmarrja politike brenda KQZ-së. Pavarësisht këtyre vonesave, Zyra ka treguar përkushtim ndaj përgjegjësive të saj, duke operuar në mënyrë të pavarur dhe pa ndonjë rast të dokumentuar të ndikimit politik.

2.1 Burimet dhe stafi

Zyra operon pa një linjë të veçantë buxhetore, duke u mbështetur vetëm në alokimet nga buxheti i përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Buxheti i saj kryesisht mbulon pagat e stafit dhe mundësi tejet të kufizuara për trajnime, si dhe një shumë prej 240,000 eurosh të destinuara për kontraktimin e kompanive të jashtme të auditimit. Ministria e Financave ende nuk i ka ndarë Zyrës një kod specifik buxhetor brenda buxhetit të konsoliduar vjetor të shtetit – respektivisht brenda buxhetit të ndarë për KQZ-në. Kjo mangësi ka implikime të rëndësishme, duke kufizuar autonominë dhe efikasitetin e saj në menaxhimin e burimeve dhe përmbushjen e mandatit.

Numri i stafit mbetet po ashtu një çështje kritike. Me vetëm shtatë të punësuar dhe një pozicion të tetë në proces rekrutimi, Zyra ende nuk e ka përmbushur përcaktimin ligjor, të vendosur në vitin 2022, për të pasur të paktën dhjetë persona si staf profesional. Aktualisht, ekipi përfshin katër persona të angazhuar në kontroll financiar, dy për regjistrimin dhe funksionimin e partive, një ekspert të bazave të të dhënave dhe një ekspert juridik.

2.2 Performanca dhe efikasiteti

Zyra për Kontroll Financiar ka bërë përparime të dukshme në përmbushjen e mandatit të saj gjatë vitit 2024, duke reflektuar progres dhe sfida në mbikëqyrjen e financimit të partive politike. Aktivitetet e saj përfshinë caktimin e auditorëve, monitorimin dhe zbatimin e përputhshmërisë me rregulloret financiare.

Një fokus kritik i punës së Zyrës ishte identifikimi dhe adresimi i parregullsive financiare në donacionet e partive politike. Gjatë rishikimit të raporteve financiare të vitit 2023, Zyra evidentoi pesë subjekte politike që kishin pranuar donacione në kundërshtim me ligjin. Për shembull:

- **Lëvizja për Bashkim** tejkaloi kufirin ligjor për donacione me 400 euro nga një donator i vetëm. Në përputhje me udhëzimet e Zyrës, partia ktheu menjëherë shumën e tejkaluar.
- Parti të tjera, si **Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës,** pranuan donacione në para të gatshme, që janë të ndaluara me ligj. Ndërsa disa parti iu përgjigjën udhëzimeve për t'i kthyer këto fonde, të tjera u ndëshkuan për mos-përputhje.

Sa i përket bashkëpunimit me institucionet tjera, Zyra i ka përcjellë gjetjet e auditorëve tek disa institucione. Administratës Tatimore i janë përcjellë raportet e pesë subjekteve politike[1], kryesisht për shkak të probleme me mospagim të obligimeve tatimore, qoftë për qiratë e objekteve të partive, pagave të zyrtarëve, apo vonesa të tjera në raport me detyrimet tatimore. Në anën tjetër, për shkak të dyshimeve mbi raste potenciale penale, Zyra i ka përcjellë raportet e tri subjekteve politike[2] tek Zyra e Prokurorit të Shtetit.

Këto raste ilustrojnë aftësinë e Zyrës për të identifikuar dhe adresuar shkeljet, duke theksuar gjithashtu nevojën për mekanizma më të fortë për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore.

Zyra ka ndërmarrë hapa proaktivë për të forcuar mbikëqyrjen dhe monitorimin. Këto përpjekje përfshijnë **verifikimin e zyrave të partive politike dhe monitorimin e uebfaqeve të tyre.** Në bashkëpunim me komisionet komunale zgjedhore, Zyra ka mbledhur të dhëna mbi selitë dhe degët e subjekteve politike. Këto informacione kanë shërbyer për auditimet dhe për të përmirësuar mbikëqyrjen e përgjithshme. Përveç kësaj, për të promovuar transparencën, Zyra ka shqyrtuar faqet e internetit të partive politike për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat për publikimin e raporteve financiare dhe listave të donatorëve.

1 Kosova Demokratik Türk Partisi, Nova Demokratska Stranka, Jedintsvena Goranska Partija, Socijaldemokratska Unija, si dhe Yenilikçi Türk Hareket Partisi.

2 Partia e Ashkalinjëve për Integrim, Socialdemokratska Unija, si dhe Srpska Lista.

PROCESI I AUDITIMIT TË RAPORTEVE TË SUBJEKTEVE POLITIKE

Auditimi i raporteve vjetore financiare të subjekteve politike për vitin 2023, i zhvilluar në përputhje me standardet e kontabilitetit të zbatueshme në Kosovë, kishte për qëllim sigurimin e përputhshmërisë me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP). Procesi përfshiu auditimin e raporteve vjetore financiare të dorëzuara nga partitë politike për periudhën raportuese nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2023.

Shërbimet e auditimit u kryen nga kompania **Audit & Conto L.L.C.**, e përzgjedhur përmes një procesi të prokurimit. Pas përzgjedhjes së tyre, procesi i auditimit filloi zyrtarisht më 18 prill 2024.

Për të siguruar shpërndarjen e paanshme të përgjegjësive të auditimit, u zhvillua një short i rastësishëm. Auditorët e licencuar u caktuan partive politike përmes një sistemi transparent të rastësisë, duke ndarë 54 partitë politike ndërmjet dhjetë auditorëve. Nga këto 54 subjekte, 15 ishin të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës dhe përfitonin mbështetje financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike.

Deri më 25 qershor 2024, kompania e auditimit dorëzoi raportet përfundimtare në Zyrën për Kontroll Financiar. Menjëherë pas kësaj, këto raporte u ndanë me përfaqësuesit e partive politike dhe u bënë publike në uebsajtin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Ndërsa auditimet evidentuan përparime në mbikëqyrje, ato gjithashtu zbuluan sfida të vazhdueshme që duhet të adresohen, veçanërisht në prag të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025.

54
Parti Politike

↓

15
ishin të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës dhe përfitonin mbështetje financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike.

Deri më 25 qershor 2024, kompania e auditimit dorëzoi raportet përfundimtare në Zyrën për Kontroll Financiar. Menjëherë pas kësaj, këto raporte u ndanë me përfaqë-suesit e partive politike dhe u bënë publike në uebsajtin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Ndërsa auditimet evidentuan përparime në mbikëqyrje, ato gjithashtu zbuluan sfida të vazhdueshme që duhet të adresohen, veçanërisht në prag të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025.

3.1 Opinionet dhe gjetjet nga auditimi

Auditimi i vitit 2023 zbuloi një panoramë komplekse të përputhshmërisë ndërmjet 54 subjekteve politike të audituara. Ndërsa disa parti treguan përparime në respektimin e rregulloreve financiare, të tjera përballeshin me mangësi të rëndësishme, duke rezultuar në opinione të rezervuara ose mohime. Gjetjet evidentuan çështje të përsëritura si dokumentimi i paplotë, mosrespektimi i rregullave të prokurimit dhe sfida në transparencën e raportimit të donacioneve.

Nga gjetjet e auditorit, raportet përfundimtare të auditimit për vitin 2023 kategorizuan subjektet politike në tre grupe kryesore të opinioneve. Pesë parti politike morën opinione të pa kualifikuara, duke reflektuar pajtueshmëri të plotë me rregulloret financiare dhe standardet e raportimit. Në kontrast, katërmbëdhjetë subjekte u vlerësuan me opinione të kualifikuara, që tregojnë pajtueshmëri të pjesshme, por me mangësi të dukshme, si dokumentacion i paplotë apo mangësi procedurale.

Grupi më shqetësues përfshin 35 subjekte politike, të cilat morën mohime të opinioneve. Ky rezultat thekson mangësi serioze në menaxhimin financiar, përfshirë dokumentacion të pamjaftueshëm, mosrespektim të dispozitave ligjore dhe mungesë të përgjegjshmërisë. Këto gjetje nënvizojnë nevojën urgjente për mbikëqyrje të përmirësuar dhe praktika financiare më të mira në një pjesë të madhe të subjekteve politike në Kosovë.

Në bazë të gjetjeve nga raportet përfundimtare të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të vitit 2023, Zyra ka shqiptuar gjithsej 20 gjoba, që përfshijnë 14 subjekte politike. Nga këto subjekte, shtatë janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ndërsa shtatë të tjera nuk kanë përfaqësim parlamentar.

Gjithsej, ndaj subjekteve politike janë shqiptuar gjoba në vlerë prej 82 mijë eurosh. Përveç kësaj, dy gjoba të tjera, në vlerë totale prej 2 mijë eurosh, janë shqiptuar ndaj zyrtarëve të caktuar të partive politike. Për më tepër, Zyra ka dhënë edhe njëzet (20) vërejtje të tjera ndaj subjekteve politike, duke theksuar mangësitë dhe mospërputhjet me kërkesat ligjore dhe rregulloret financiare.

LDK PDK
LVV AK

Për partitë kryesore, si Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK), auditorët patën gjetje të ndryshme në raport me menaxhimin financiar. Këto parti u gjetën të kishin probleme të përsëritura me dokumentimin e shpenzimeve kryesore, duke përfshirë reklamat dhe udhëtimet. Në shumë raste, shpenzimet u realizuan pa dokumentacion mbështetës adekuat, duke kufizuar aftësinë e auditorëve për të verifikuar saktësinë dhe legjitimitetin e aktiviteteve të raportuara. Për më tepër, këto parti nuk respektuan në mënyrë të vazhdueshme rregulloret dhe procedurat e prokurimit, të cilat kërkojnë tenderë të hapur për blerjet mbi shuma të caktuara. Edhe për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, e cila megjithatë mori opinion të pakualifikuar u vunë re çështje të vogla, përfshirë të dhëna të paplota për marrëveshjet e qirave, që tregojnë nevojën për përmirësim të mëtutjeshëm.

Nga ana tjetër, Lista Serbe (SL) mori një mohim opinioni për shkak të mangësive të rënda në dokumentacionin financiar. Dështimi i partisë për të justifikuar shpenzimet kritike, veçanërisht për reklamat dhe përfaqësimin, lë hapësirë për dyshime serioze, me theks tek aktivitetet e realizuara rreth hulumtimit të opinionit publik nga organizatat jo qeveritare të kontraktuara nga ky subjekt politik, në vlerën 100,000 euro, për të cilat nuk u paraqitën dëshmi bindëse para auditorëve – se aktivitetet janë realizuar.

Auditimet gjithashtu zbuluan shkelje të vazhdueshme të ndalimit ligjor për pranimin e donacioneve në para të gatshme. Disa parti të vogla, duke përfshirë Partinë Shqiptare Demokristiane të Kosovës, pranuan donacione të gatshme, një praktikë e ndaluar në mënyrë eksplicite sipas LFSP-së. Ndërsa disa parti respektuan udhëzimet e Zyrës për të kthyer këto fonde, të tjera dështuan të veprojnë brenda afatit të specifikuar, duke çuar në gjoba dhe sanksione tjera.

3.2 Problematikat e vazhdueshme në financimin e partive politike

Në krahasim me vitet e kaluara, auditimet e vitit 2023 treguan një përmirësim në raport me mbikëqyrjen financiare. Megjithatë, shumë nga sfidat e identifikuara në ciklet e mëparshme të auditimit mbeten të pazgjidhura, duke përfshirë:

- Mospërputhjet në dokumentimin e shpenzimeve kryesore;
- Mosrespektim të rregullave të prokurimit për blerje të rëndësishme;
- Mekanizma të paqëndrueshëm që garantojnë zbatim të dispozitave.

Subjektet më të mëdha, si LVV dhe PDK, përgjithësisht treguan sisteme më të forta për identifikimin e të ardhurave, ndërsa partitë më të vogla shpesh mungonin burimet dhe ekspertizën e nevojshme për të përmbushur standardet rregullatore.

Një çështje që mbetet jashtë fushës së procesit të auditimit, por që është kritike për transparencën e gjerë të financimit politik, është qasja publike në qarkullimet e llogarive bankare. Aktualisht, partitë politike janë të detyruara të dorëzojnë të dhëna të detajuara mbi transaksionet e tyre bankare. Megjithatë, këto të dhëna nuk bëhen publike nga Zyra, duke kufizuar aftësinë e shoqërisë civile, mediave dhe votuesve për të verifikuar në mënyrë të pavarur praktikat financiare.

Publikimi i qarkullimeve të detajuara të llogarive bankare është thelbësor për forcimin e llogaridhënies. Ky hap do të reduktonte ndjeshëm parregullsitë financiare dhe do të harmonizonte praktikat e financimit politik të Kosovës me standardet ndërkombëtare. Mungesa e kësaj transparence minon besimin e publikut dhe të hapësirë për keqpërdorim të mundshëm të fondeve.

3.3. Përmbledhje e detajuar e gjetjeve specifike për partitë politike

Auditimet e partive politike në Kosovë për vitin financiar 2023 zbuluan një gamë të gjerë çështjesh, duke evidentuar boshllëqe të vazhdueshme në transparencë, raste të mosrespektimit të dispozitave ligjore dhe rreziqe të parregullsive në menaxhimin financiar.

3.3.1 Përmbledhje e detajuar e gjetjeve specifike për partitë politike

Transparenca mbetet një sfidë thelbësore për shumë parti politike, veçanërisht në dokumentimin dhe raportimin e shpenzimeve. Subjektet më të mëdha, si Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), raportuan shpenzime të konsiderueshme për reklama, aktivitete dhe udhëtime. Megjithatë, auditorët identifikuan boshllëqe në dokumentacionin mbështetës për këto aktivitete, duke kufizuar aftësinë për të verifikuar legjitimitetin dhe përputhshmërinë me rregulloret financiare.

PDK

Për shembull, PDK raportoi shpenzime të konsiderueshme për llogaritë e pagueshme– në vlerë prej rreth 150 mijë eurosh nga vitet e kaluara, por faturat ishin të paplota ose të paqasshme. Po ashtu, ndonëse PDK-së i janë evidentuar 39 zyra dhe degë nëpër komunat tjera, e njëjta ka deklaruar vetëm dy sosh.

V

Në mënyrë të ngjashme, shpenzimet e LVV për shpenzimet e ushqimit, reprezentacionit, komunikimit dhe derivatet, mungonin dokumentacionin e mjaftueshëm, duke e bërë të vështirë vlerësimin e përdorimit të duhur të fondeve.

Këto probleme të transparencës nuk ishin të kufizuara vetëm te partitë më të mëdha; edhe subjektet më të vogla hasën vështirësi në sigurimin e raportimeve të qarta dhe të qëndrueshme.

3.3.2 Mosrespektimi i dispozitave ligjor

Disa parti kanë shfaqur shkelje të qarta të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP). Çështja më e zakonshme ishte pranimi i donacioneve në para të gatshme, që ndalohet në mënyrë eksplicite. Auditorët identifikuan disa subjekte, duke përfshirë Partinë Shqiptare Demokristiane të Kosovës dhe Partinë Demokratike të Ashkanlive të Kosovës, si përfituese të kontributeve të paligjshme në para të gatshme. Edhe pse u dhanë udhëzime për kthimin e këtyre fondeve, jo të gjitha partitë vepruan brenda afatit të caktuar, duke sjellë sanksione.

Gjithashtu, mosrespektimi i ligjeve të prokurimit ishte një problem i përsëritur. Partitë e mëdha, e sidomos LVV dhe LDK u kritikuar për dështimin në respektimin e kërkesave për tenderim të hapur për blerjet e mëdha. Partitë më të vogla gjithashtu treguan mosrespektim, megjithëse në një shkallë më të ulët, shpesh për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe njohurive rregullative.

LVV, PDK dhe LDK, u evidentua që, në kundërshtim me ligjin, mbanin më shumë se një xhirollogari aktive bankare.

Një tjetër fushë shqetësimi ishte raportimi i gabuar ose mosraportimi i kontributeve në natyrë. Auditorët vunë re raste kur partitë dështuan të deklaronin shërbime ose mallra të ofruara nga palë të treta, duke shkelur kërkesën për deklarim të plotë financiar. Kjo praktikë jo vetëm që bie ndesh me dispozitat ligjore, por edhe shtrembëron peizazhin financiar duke nënvlerësuar burimet aktuale në dispozicion të partive politike.

3.3.3 Rreziqet dhe parregullsitë në menaxhimin financiar

Auditimet zbuluan disa rreziqe dhe parregullsi që mund të kompromet ojnë integritetin financiar të subjekteve politike. Një çështje e përsëritur ishte menaxhimi i papërshtatshëm i fondeve në nivelin e degëve. Për shembull, PDK dhe LDK u identifikuan me kontrolle të dobëta të brendshme, duke rezultuar në transaksione të pavërtetuara dhe ruajtje të paqëndrueshme të të dhënave në zyrat rajonale.

Në partitë më të vogla, rreziqet lidheshin kryesisht me mungesën e strukturave profesionale të menaxhimit financiar. Shumë prej këtyre subjekteve mbështeteshin në sisteme ad hoc për evidentimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke rritur gjasat për gabime ose mungesa. Për shembull, Lista Serbe tregoi mangësi serioze në mbikëqyrjen financiare, ku auditorët nuk arritën të verifikonin pjesë të mëdha të shpenzimeve të raportuara.

Një tjetër fushë rreziku ishte keqpërdorimi ose alokimi i gabuar i fondeve publike. Partitë që përfituan nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike shpesh dështuan të demonstrojnë lidhje të qarta midis shpenzimeve të tyre dhe qëllimeve për të cilat ishin destinuar këto fonde. Ky problem ishte veçanërisht evident në aktivitetet promovuese, ku shuma të mëdha u shpenzuan me pak dëshmi të ndikimit ose respektimi të standardeve të prokurimit.

3.4 Trende krahasimore mes viteve 2023 dhe 2022

Një analizë krahasuese e gjetjeve të auditimeve për vitet 2022 dhe 2023 thekson si vazhdimësinë ashtu edhe përparimet në mbikëqyrjen e financimit të partive politike.

Megjithatë, shumë nga sfidat e identifikuara në auditimet e vitit 2022 mbeten të pazgjidhura. Mangësitë në dokumentacion, kontrollet e dobëta të brendshme financiare dhe shkeljet e përsëritura të rregulloreve të prokurimit vazhdojnë të minojnë transparencën financiare. Ndërsa gjobat për mosrespektim janë bërë më të shpeshta, përsëritja e çështjeve të ngjashme ndër vite sugjeron se vetëm sanksionet nuk mjaftojnë për të pasur ndryshime sistemike.

Një ndryshim i dukshëm midis viteve 2022 dhe 2023 ishte forcimi i zbatimit të rregulloreve që lidhen me donacionet në para të gatshme. Vendosja e gjobave për partitë që pranojnë donacione të gatshme ka qenë më konsistente, duke pasqyruar përpjekjet e Zyrës për të adresuar këtë çështje të vazhdueshme.

3.5 Implikimet për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025

Gjetjet nga auditimet e vitit 2023 kanë implikime të rëndësishme për zgjedhjet e ardhshme parlamentare në Kosovë, të planifikuara për 9 shkurt 2025. Financimi transparent dhe i përgjegjshëm i fushatave politike është thelbësor për të siguruar një proces zgjedhor të drejtë dhe demokratik. Çështjet e përsëritura të identifikuara në auditime, si shpenzimet e padokumentuara, mosrespektimi i rregullave të prokurimit dhe pranimi i vazhdueshëm i donacioneve të gatshme, mund të dëmtojnë besueshmërinë e financimit të fushatave gjatë periudhës zgjedhore.

Gjetjet gjithashtu nënvizojnë urgjencën e adresimit të dobësive sistemike përpara ciklit të ardhshëm zgjedhor. Sigurimi që partitë politike t'i përmbahen rregulloreve financiare dhe që Zyra për Kontroll Financiar të ketë kapacitetin për të zbatuar në mënyrë efektive përputhshmërinë do të jenë thelbësore. Për më tepër, rritja e transparencës, veçanërisht përmes publikimit të qarkullimeve të llogarive bankare, mund t'u ofrojë votuesve më shumë besim në integritetin e subjekteve politike.

Ndërsa partitë përgatiten për zgjedhjet e ardhshme, aftësia e tyre për të demonstruar llogaridhënie financiare mund të ndikojë në perceptimin dhe besimin e publikut.



PËRMBLEDHJE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR VITIN 2023

Raportet financiare të vitit 2023 të partive politike në Kosovë tregojnë një varësi të konsiderueshme në financimin publik, të plotësuar nga burime të tjera si donacionet dhe kuotat e anëtarësisë. Për 54 subjektet e audituara, të ardhurat dhe shpenzimet totale ndryshuan ndjeshëm, duke reflektuar pabarazitë në madhësinë, shtrirjen dhe kapacitetin për të mobilizuar burime. Në total, partitë politike raportuan miliona euro në të ardhura, me partitë e mëdha si LVV, PDK, dhe LDK që dominuan skemën e përgjithshme financiare falë qasjes së tyre në buxhetin e shtetit.

Të ardhurat nga buxheti i shtetit mbeten burimi kryesor i financimit për subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, duke përbërë një pjesë të konsiderueshme të financave totale të partive. Në vitin 2023, 15 parti politike përfituan nga ky financim publik përmes Fondit për Mbështetjen e Subjekteve Politike, i cili ndan burimet bazuar në përqindjen e votave dhe ulëseve të fituara në zgjedhjet e mëparshme. Këto fonde synojnë të mbështesin aktivitetet e rregullta të partive dhe të sigurojnë një fushë të barabartë të garës politike.

Shpenzimet e partive kryesisht u përqendruan në kostot e personelit, shpenzimet operative dhe aktivitetet promovuese. Shuma e përgjithshme e shpenzimeve është rreth **3.5** milionë euro, nga rreth **4.6** milion euro të hyra – që paraqet një nivel mesatar shpenzimi prej rreth **75%** të buxheteve.

60% e shpenzimeve të të gjitha subjekteve politike parlamentare janë bërë për kategorinë e pagave dhe kompensimeve, rreth **16%** në shpenzime të përgjithshme, **12%** në reklama, reprezentacion dhe konferenca, ndërsa rreth **5%** në shpenzime transporti.

4.1 Trendet kryesore në burimet e financimit

Një analizë e burimeve të financimit thekson dominimin e financimit publik në financat e partive, të plotësuar nga kontributet private. Për parti të mëdha si LVV dhe PDK, financimi publik përbënte më shumë se 80% të të ardhurave totale.

Kuotat e anëtarësimit përbënin një pjesë të vogël të të ardhurave të partive. Ndërsa këto kuota raportoheshin rregullisht nga disa subjekte, kontributi i tyre në të ardhurat totale ishte i vogël. Për partitë më të vogla, mbështetja te donacionet individuale ishte më e theksuar, edhe pse shumën shpesh ishin modeste krahasuar me buxhetet e subjekteve më të mëdha.

Trendi i mbështetjes së ulët te financimi privat për shumicën e partive ngre pyetje mbi diversifikimin e burimeve financiare. Mbështetja e tepruar te financimi publik mund të krijojë cenueshmëri, veçanërisht në një kontekst zgjedhor ku alokimi i burimeve luan një rol kritik në formësimin e konkurrencës.

4.2 Krahasimi i kategorive të shpenzimeve kryesore

Modelet e shpenzimeve të partive politike në vitin 2023 zbulojnë dallime të konsiderueshme në mënyrën se si fondet janë përdorur. Për të gjitha subjektet e audituara, tre kategori kryesore dominuan shpenzimet: kostot e personelit, shpenzimet operative dhe aktivitetet e reklamimit ose promovimit. Megjithatë, alokimi proporcional i fondeve brenda këtyre kategorive ndryshonte dukshëm midis partive.

- **Kostot për personel:** Pagat dhe përfitimet për anëtarët e stafit përbënin një shpenzim të rëndësishëm për partitë parlamentare – me rreth 2 milion euro të shpenzuara. Partitë e mëdha, veçanërisht LVV, PDK,

dhe LDK, raportuan alokime të konsiderueshme për paga dhe kompensime. Në kontrast, partitë më të vogla alokuan një pjesë shumë më të vogël të buxheteve të tyre për paga, shpesh duke u mbështetur te përpjekjet vullnetare për të mbajtur operacionet.

- **Shpenzimet operacionale:** Qiratë, shërbimet komunale dhe kostot administrative ishin një kategori e qëndrueshme shpenzimesh për të gjitha subjektet. Ndërsa partitë më të mëdha mbanin zyra në disa komuna, duke shkaktuar kosto më të larta operative, partitë më të vogla shpesh operonin me infrastrukturë minimale. Megjithatë, mospërputhjet në raportimin e shpenzimeve për qira dhe shërbime komunale u evidentuan në disa gjetje të auditimit.

- **Reklamimet dhe aktivitetet tjera promovuese:** Reklamat përbënin një nga kategoritë të shpenzimeve (më pak se 15% e shpenzimeve të gjithmbarshme të partive parlamentare). Shpenzimet për reklama mediatike, ngjarje publike dhe fushata digjitale u raportuan më shumë nga LVV dhe PDK. Megjithatë, auditimet zbuluan boshllëqe në dokumentimin e këtyre shpenzimeve, duke ngritur shqetësime mbi transparencën dhe respektimin e normave tjera të raportimit financiar.

REKOMANDIMET

Gjetjet nga cikli i auditimit të vitit 2023 dhe analiza më e gjerë e financimit të partive politike në Kosovë, theksojnë boshllëqe në transparencë, llogaridhënie dhe përputhshmëri me legjislacionin. Me afrimin e zgjedhjeve parlamentare të shkurtit 2025, por edhe viteve tjera raportuese financiare në përgjithësi, adresimi i këtyre mangësive është thelbësor për të siguruar një proces të drejtë dhe demokratik.

Rekomandimet e mëposhtme, të bazuara në të dhënat e këtij raporti, synojnë forcimin e kuadrit të mbikëqyrjes financiare, nxitjen e përputhshmërisë së partive dhe harmonizimin e praktikave me standardet ndërkombëtare:

5.1 Rritja e transparencës dhe qasjes së publikut në informata

- Të publikohen raportet bankare, që përfshijnë të gjitha qarkullimet dhe transkasionet bankare. Ky hap do t'i mundësonte shoqërisë civile, mediave dhe votuesve të shqyrtojnë financat e partive dhe të zbulojnë parregullsi. Masa është në përputhje me praktikat ndërkombëtare në vende si Gjermania dhe Kanadaja.

- Të publikohen raporte të detajuara financiare, që përfshijnë ndarjen shumë më të detajuar në kategoritë e të ardhurave dhe shpenzimeve.

- Të adaptohet një format i standardizuar për raportimin financiar. Kjo masë do të përmirësojë qartësinë dhe konsistencën e raportimit financiar, duke lehtësuar edhe krahasimet ndërmjet partive dhe duke siguruar që të gjitha subjektet të përmbushin kërkesat e njëjta të deklarimit financiar.

5.2 Nxitja e përputhshmërisë me dispozitat ligjore

- Të rriten ndjeshëm gjobat për shkeljet e përsëritura të rregulloreve financiare, si pranimi i donacioneve në para të gatshme ose mosrespektimi të dispozitave ligjore.

- Të krijohet një mekanizëm më rigoroz brenda Zyrës, përmes së cilit verifikohet nëse partitë zbatojnë veprimet korrigjuese të rekomanduara nga auditorët dhe nga vet Zyra.

5.3 Përmirësimi i mbikëqyrjes financiare dhe kapaciteteve të Zyrës

- Të alokohet një kod i veçantë buxhetor Zyrën, i ndarë nga buxheti i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për të rritur pavarësinë operacionale të Zyrës.

- Të rekrutohet staf shtesë profesional për të përmbushur kërkesat ligjore, duke u fokusuar në zgjerimin e ekspertizës në auditimin financiar.

5.4 Fuqizimi i menaxhimit të brendshëm financiar brenda partive politike

- Të organizohen programe trajnimi për partitë më të vogla për të përmirësuar praktikat e tyre të menaxhimit financiar. Këto programe duhet të përqendrohen në mbajtjen e të dhënave, përputhshmërinë me legjislacionin e prokurimit dhe dokumentimin e duhur të shpenzimeve.

- T'u kërkohet të gjitha partive politike që të zbatojnë dhe të mbajnë rregulla të brendshme të kontrollit financiar, përfshirë auditime të brendshme të rregullta. Kjo masë do t'a reduktonte rrezikon e keqmenaxhimit financiar dhe do t'a përmirësonte zbatimin e dispozitave ligjore.

Me përkrahjen financiare të:

TRANSITION